



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 151, Datë 03.07.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOMI TEC” SH.P.K NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PLEPI” ME FUQI TË
INSTALUAR 2285 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 03.07.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “DOMI TEC“ sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DOMI TEC” sh.p.k. me shkresën nr. 29 Prot., datë 25.04.2018, protokolluar në ERE me nr. 344 Prot., datë 26.04.2018, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Plepi” me fuqi të instaluar 2285 KW.
- Në vijim të këtij aplikimi Bordi i ERE me vendimin nr. 112, datë 14.05.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë DOMI TEC” sh.p.k për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Plepi”.
- ERE me shkresën nr. 55/30 Prot., datë 14.05.2018, ka bërë njoftimin në media për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit.
- ERE me shkresën nr. 344/1 Prot., datë 15.05.2018, i ka bërë me dije subjektit mungesën e dokumentacionit të kërkuar.

- ERE me shkresën nr. 344/3 Prot., datë 21.05.2018, ka njoftuar subjektin në lidhje me vendimarrjen e Bordit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 344/2 Prot., datë 25.05.2018, subjekti ka përcjellë në ERE plotësimin e dokumentacionit të munguar duke depozituar vërtetimet nga Prokuroria dhe Gjykata, si dhe Studimin e Fizibilitetit.
- ERE në mbledhjen e datës 25.06.2018 pranoi kërkesën e shoqërisë “DOMI TEC“ sh.p.k për shtyrjen e vendimarrjes, në lidhje me plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me Lejen e përdorimit të ujit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 344/5, datë 25.06.2018, “DOMI TEC“ sh.p.k ka përcjellë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor nr. 272/1 Prot., datë 20.06.2018, të miratuar me vendimin e Këshillit të Basenit Ujqor Drin – Bunë.
- Në përfundim të shqyrtimit, rezulton se aplikimi i shoqërisë “DOMI TEC” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”* si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “DOMI TEC“ sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Plepi” me fuqi të instaluar 2285 KW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.